KËRKESË
Nr. 220/4, datë 19.5.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 558, datë 18.6.2015, "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti 'Unaza Veriore Korçë"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në ARRSH, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 738,430 (shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e tridhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "UNAZA VERIORE KORÇË"

NR.	PRONARI			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqe e shpronësuar	Çmimi, lek/m^2	Vlera totale (lek)	Adresat	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Llambi	Andon	Tona	8563	2/150	352	Truall	98	7535	**738,430**	Bashkia Korçë	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera paraprake										**738,430**		